



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:280148
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05391331

A.C.nr.81/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit : Besnik Bislimaj, Kryetar, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Leonora Recaj, kundër të paditurit B. B. M. nga fshati V., Komuna e Vitisë, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 12,471.00€, duke vendosur lidhur me ankesat e paditëses dhe të paditurit, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.137/2012 datë 28.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.02.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

APROVOHEN si të bazuar ankesat e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë dhe të paditurit B. M. nga fshati Vërban, Komuna e Vitisë. PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.137/2012 datë 28.10.2020, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin C.nr.137/2012 datë 28.10.2020, ka vendosur: **I. Aprovohet** pjesërisht si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurit B. B. M. nga fshati V., Komuna e Vitisë, dhe detyrohet i padituri, që paditëses t’ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 6,235.50€ në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në komunikacionin rrugor të datës 15.05.2011, të ndodhur në rrugën Viti-G., në fshatin D., Komuna e Vitisë, me kamatë vjetore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e përpilimit të Aktgjykimit e deri në pagesën definitive, krejt në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, në lartësi prej 6,235.50€ e kërkuar më tepër se shuma e gzykuar, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në komunikacionin rrugor të datës 15.05.2011, të ndodhur në rrugën Viti-G., në fshatin D., Komuna e Vitisë.

III. Detyrohet i padituri B. M. nga fshati V., Komuna e Vitisë, që paditëses tia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 200€ në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat ligjore të përmbartimit të dhunshëm ligjor.

Kundër pikës II të këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësja, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që të miratohet ankesa e paditëses në tërësi si e bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj në pikën II, ashtu që ta aprovojë në tërësi kërkesë padinë e paditëses, apo të njëjtin ta prish dhe lënda të kthehet në procedurë të serishme.

Gjithashtu kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që të miratohet ankesa e të paditurit dhe të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në procedurë të serishme.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktvendimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

-Ankesat e paditëses dhe e të paditurit, janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, me datë 28.05.2012, ka paraqitur padi, kundër të paditurit B. M. nga fshati V., Komuna e Vitisë, për shkak të rimbursimit të dëmit, me vlerës të kontestit në shumë prej 12,471.00 euro.

Gjykata e shkallës së parë, me propozim të palëve ndërgjyqëse, ka marrë aktvendim C.nr. 137/2012 të datës 07.10.2020, përmes së cilës ka bashkuar shkresat e lëndës C.nr. 137/2012, C.nr. 342/2013 si dhe C.nr. 114/2014 me vlerë të kontestit në shumë prej 12,471.00 euro, ashtu që lënda është udhëhequr sipas lëndës me nr. C.nr. 137/2012.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancën e shqyrtimit kryesor, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.137/2012 datë 28.10.2020, me të cilin aktgjykim Pjesërisht është aprovuar kërkesë padia e paditëses, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike janë administruar këto prova: Kopja e transferi bankar për bankën ekonomike ne Prishtinë, ku ne emër të J. I., për E. F. janë deponuar shuma e të hollave prej 3.855.00 euro, Kopja e urdhertranseferit me numër 1658/12, lëshuar nga BKS-ja, Ujdia Jashtëgjyqësore e lidhur me datë 12.10.2012 , në mes të paditëses dhe E. F., Vendimi BKS me

numër; FK-705/2012, i datës 30.07.2012, Vendimi me numër te njëjtë të dosjes i datës 12.10.2012, lëshuar nga komisioni i shkallës së dytë për trajtimin e dëmeve nga BKS-ja, Ankesa e te autorizuarit E. F., avokatit Arber Istrefi, Formulari për kompensimin e demit jomaterial ne emër të E. F., i datës 30.07.2012, Vendimi i komisionit për trajtimin e dëmeve dosja numër 809/11, e datës 08.06.2011, Raporti policor me numër CR-3004-166/11, datës 15.05.2011, se bashku me skicën e matjeve nga vendi i ngjarjes dhe foto nga vendi i ngjarjes, Kërkesa për shqyrtimin e lendes me numër 705/12, Kërkesa për kompensimin e demit drejtuar paditëses nga i dëmtuari E. F., Kopje e transporti bankar e kryer nga ane e paditëses, Ujdia jashtëgjyqësore me numër 806/11, e datës 14.07.2011, e lidhur ne mes te paditëses dhe H. Y., Vendimi i komisionit për trajtimet e dëmeve 806/11, e datës 15.06.2011, ne emër të H. Y., Formulari për kompensimin e demit jomaterial, përpiluar nga ana e paditëses, Vlerësimi mjekësor lëshuar nga GFK- në emër të H. Y. Transferi bankar ne emër të D. Y., Formulari për kompensimin e demit jomaterial ne emër të D. Y., Ujdia jashtëgjyqësore numër 807/11, e datës 14.07.2011, e lidhur ne mes te paditëses dhe D. Y., Vlerësimi mjekësor ne emër të D. Y., Kopja e transferit bankar në emër të Xh. B., Ujdia jashtëgjyqësore numër 808/11, datës 15.09.2011, e lidhur ne mes te paditëses dhe Xh. B., Formulari për kompensimin e demit jo material ne emër të X. B., Vendimi i komisioni për trajtimin e dëmeve dosja numër 809/11, datës 08.06.2011, Ujdia jashtëgjyqësore numër 809/11, e datës 14.09.2011, e lidhur me mes paditëses dhe Xh. B., Urdhertransferi lëshuar nga GFK, Kërkesa për kompensimin e demit, Kopja e transferit bankar në emër të M. B., Formulari për kompensimin e demit jomaterial, Ujdia jashtëgjyqësore me numër 855/11, datës 15.07.2011, e lidhur ne mes paditëses dhe M. B., Vlerësimi mjekësore ne emër të M. B., Transferi bankarë në emër të F. B., Formulari për kompensimin e demit jomaterial, Ujdia jashtëgjyqësore numër 854/11, datës 15.09.201, e lidhur ne mes paditëses dhe Festim Beratit, Vlerësimi mjekësor ne emër te Festim Beratit, Formulari për kompensimin e demit jomaterial, Vendimi komisionit për trajtimin e dëmeve dosja numër 857/11, datës 22.06.2011, Ujdia jashtëgjyqësore numër 857/11, datës 14.07.201, e lidhur ne mes paditëses dhe Sokol Beratit, Formulari për kompensimin e demit jo material në emër të I. S., Vendimi komisionit për trajtimin e dëmeve dosja numër 858/11, datës 22.06.2011, Ujdia jashtëgjyqësore numër 858/11, datës 15.07.201, e lidhur ne mes paditëses dhe I.S., Vendimi komisionit për trajtimin e dëmeve dosja numër 859/11, datës 22.06.2011, Formulari për kompensimin e demit jo material në emër të F. B., Ujdia jashtëgjyqësore numër 859/11, datës 15.07.201, e lidhur ne mes paditëses dhe F. B., Ekspertiza teknike e komunikacionit e kryer nga ane e ekspertit te autorizuar E. A. e datës 20.12.2018 si dhe Ekspertizën e aksidentit te komunikacionit te datës 05.10.2020, te kryer nga eksperti M. H. inxh i diplomuar, dëgjimin e ekspertit dhe ballafaqimin e tij me ekspertizën e komunikacionit të dt. 20.12.2018, të ekspertit të komunikacionit rrugor E. A., nga të cilat prova është vërtetuar pjesërisht themelësia e kërkesë padisë së paditëses, ashtu që është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 185 të LMD-së si dhe nenin 18.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Vendimin mbi kamatën e gjykuar e ka marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes tani për tani nuk mund të pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.1 dhe 182 parag.2 pika n) të LPK-së, gjendja faktike nuk është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe si rezultat i kësaj edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore konsistojnë në faktin se aktgjykimi i ankimuar ka të meta, për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. Dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetë veten dhe arsyetimin e tij. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare, edhe ato pak arsye të cilat i ka dhënë nuk e arsyetojnë mënyrën e vendosjes e po ashtu janë në kundërshtim me shkresat e lëndës dhe me provat të cilat janë administruar në procesin gjyqësor në shkallë të parë, për të cilat prova nuk ka dhënë një vlerësim të duhur për mënyrën se si ka vërtetuar faktet jo kontestuese, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka listuar provat që janë administruar në këtë çështje kontestimore e në ndërkohë në procesverbalin e shqyrtimit kryesorë nuk janë të administruara të gjitha provat e listuar në arsyetim.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në aktgjykimin e ankimuar, ka theksuar se nuk e kishte administruar ekspertizën e ekspertit të komunikacionit E. A. e datës 20.12.2018, me arsyetimin se eksperti në fjalë nuk kishte licencë për kryerjen e kësaj ekspertize, gjë që gjykata e Apelit nuk pajtohet me një veprim të tillë të gjykatës së shkallës së parë pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse kjo gjykatë ven në dyshim licencën e ekspertit duke e anashkaluar faktin se në ekspertizën e përpiluar me shkrim gjendet vula zyrtare me nr. 03/18 të datës 20.12.2018 me mbishkrimin Ekspert Gjyqësorë për Komunikacion E. K. e që në këtë rast gjykata e shkallës së parë është dashur që të vërtetojë këtë saktë se eksperti në fjalë në kohën e përpilimit të ekspertizës a kishte licencë dhe në rast të vërtetimit të një fakti të tillë (mungesës së licencës), e njëjta është dashur që të përsërit ekspertizën e komunikacionit nga një ekspert tjetër pasi që eksperti paraprak ka qenë i caktuar sipas aktvendimit të kësaj gjykata C.nr. 137/12 të datës 16.11.2018 dhe në një rast të tillë nuk mund të dëmtohet paditësja nga veprimet e gjykatës pasi që paditësja nuk kishte ndikim në caktimin e ekspertit E. A.. Andaj, në raste të tillë kur gjykata në bazë të detyrës zyrtare zhvlerëson një ekspertizë, e njëjta ka për obligim të caktoj një ekspertizë të re e duke pas parasysh që në satin konkret paditësja kishte propozuar sërish nxjerrjen e një ekspertize të re duke u bazuar në vendimin e cekur më lartë mbi caktimin e ekspertit paraprak: andaj, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë është dashur që të aprovoj një propozim të tillë dhe në këtë mënyrë të respektojë parimin e barazisë së palëve dhe jo të refuzoj nxjerrjen e një ekspertize të re duke qen në dijeni se pala paditëse e kishte kundërshtuar ekspertizën e ekspertit M. H. me arsyetimin se e njëjta është në kundërshtim me ekspertizën e ekspertit E. A. dhe me shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit vlerëson se është obligim e gjykatës së shkallës së parë që të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plot gjendjen faktike dhe atë duke nxjerrë ekspertizat e nevojshme me qëllim që të vërtetohet baza juridike e kërkesës së paditësit në atë mënyrë që e njëjta administroj prova konkrete me qëllim të vërtetimit edhe të gjendjes faktike. Gjithashtu gjykata e Apelit vlerëson si të domosdoshëm që në shqyrtim kryesorë të ftohet eksperti i komunikacionit M. H. për tu deklaruar në lidhje me ekspertizën e përpiluar me shkrim dhe të sqarohet para gjykatës se mënyra e përpilimit të ekspertizën duke përcaktuar me përqindje (%) përgjegjësinë e pjesëmarrësve në aksident, pasi që një përcaktim i tillë nuk bie në kompetencë të ekspertit për të përcaktuar

përgjegjës in e pjesëmarrësve në aksident në shkallën e përgjegjës isë me përqindje pasi që i njëjti është dashur të deklarohet me përgjegjës in primare dhe ajo sekondare sepse ndarja e përgjegjës isë në përqindje (%) është kompetencë dhe vlerësim ekskluziv i gjykatës. Andaj, duke qenë se aktgjykimi i ankimuar ishte përfshirë në shkelje thelbësore dhe si rrjedhojë e kësaj edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, tani për tani edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar dhe për këtë arsye aktgjykimi i ankimuar u deshtë të prishet në tërësi dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës e parë që të veprojnë në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që pasi të konstatojë se janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale për vendosje në këtë çështje kontestimore, të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me qëllim të vërtetimit të përgjegjës isë së të paditurit në aksidentin e trafikut të datës 15.05.2011, ashtu që fillimisht të vlerësojë se eksperti E. K. në kohën e përpilimit të ekspertizës së datës 20.12.2018 a kishte licencë valide dhe nëse vërtetohet se i njëjti nuk ishte i licencuar, të caktoj një ekspertizë të re nga një ekspert tjetër, të ftoj ekspertin e komunikacionit M. H. të sqarohet në rrethanat e cekura si më lartë dhe varësisht nga rezultati i këtyre dy ekspertizave, nëse të njëjtët janë të kundërta, të caktoj një ekspertizë të tretë me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Krejt në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e vendosjes për bazueshmërinë e kërkesës së paditëses kë këtë kujdes që aktgjykimi të përpilohet në kuptim të nenin 160 të LPK-së, të aplikoj drejtë edhe të drejtën materiale, në mënyrë që të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika c), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.81/2021 datë 29.02.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v